

Numri: KSC-BC-2020-06
Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr Fidelma Donlon

Pjesëmarrës parashtrues: Mbrojtja

Data: 17 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Parashtrime të Mbrojtjes në emër të Jakup Krasniqit për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit
Dejvid Hupër QC

Mbrojtësit të Kadri Veselit
Ben Emerson QC

Mbrojtësit të Rexhep Selimit
Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Më 11 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një urdhër për caktimin e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe u kërkoi palëve që të paraqisnin parashtrimet e tyre me shkrim mbi pikat e rendit të ditës të përcaktuara në urdhrin për caktimin e datës.¹
2. Më 13 nëntor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") paraqiti parashtrimet² e saj me shkrim.
3. Mbrojtja e Jakup Krasniqit ("Mbrojtja") paraqet parashtrimet e saj si më poshtë vijon.

II. MBROJTJA DUHET TË KETË KOHË TË MJAFTUESHME PËR TË HETUAR

4. Mbrojtja do të kryejë një hetim rrënjësor të këtij rasti. Mbrojtja nuk ka marrë deri tani ndonjë material nga ZPS-ja, dhe, si rrjedhojë nuk mund të japë një vlerësim se sa kohë do t'i nevojitet për të përmbyllur veprimtarinë e saj hetimore. Mbrojtja as nuk mund të konfirmojë nëse do të paraqesë ndonjë mbrojtje afirmuese në këtë fazë.

¹ Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, KSC-BC-2020-06/F00074, 11 nëntor 2020, publik.

² Parashtrime të Prokurorisë për konferencën e parë mbi ecurinë e çështjes, KSC-BC-2020-02/F00076, 13 nëntor 2020, publike ("Parashtrimet e ZPS-së").

5. Numri dhe fushëveprimi i akuzave në Aktakuzën e rishikuar më tej³ si dhe vëllimi i materialit të përmendur në parashtrimet e ZPS-së provojnë nevojën për të kryer një hetim të zgjeruar nga ana e Mbrojtjes. Aktakuza e rishikuar më tej i ngarkon të akuzuarit me 10 akuza të ndryshme, që supozohet se janë kryer në të paktën 16 vendbanime, përgjatë një periudhe prej 18 muajsh, nga marsi 1998 deri në shtator 1999⁴. Kuadri gjeografik dhe kohor i Aktakuzës, së bashku me numrin e veprave penale konkrete që supozohet të jenë kryer, mjafton në vetvete për të provuar nevojën e Mbrojtjes për të kryer një hetim të gjatë.
6. Zyra e Prokurorit të Specializuar parashtron se do të bëjë të njohur një vëllim të konsiderueshëm provash shkresore, deklaratash dëshmitarësh dhe materialesh të tjera. Parashtrimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar tregojnë ndër të tjera se ZPS-ja është mbështetur në 153 dëshmitarë për Aktakuzën e Konfirmuar dhe parashikon shtimin edhe të 50 dëshmitarëve të tjerë⁵; janë 43.108 faqe materiale sipas rregullës 102(1)(a) që do të vihen në dispozicion⁶; ZPS-ja parashikon nxjerrjen e pothuaj 100.000 materialeve⁷ sipas rregullës 102(3), dhe janë gjithashtu edhe materiale shtesë sipas rregullës 107 dhe 103⁸.
7. Z. Krasniqi ka të drejtën për të pasur kohë dhe mundësi të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen⁹ e tij. Fushëveprimi i Aktakuzës dhe vëllimi i nxjerrjes së materialit nënkuptojnë që hetimi nga ana e Mbrojtjes do të jetë pashmangshmërisht i zgjatur. Deri kur Zyra e Prokurorit të Specializuar të ketë bërë një përparim thelbësor në përmbushjen e detyrimeve të saj për nxjerrjen e

³ Aktakuzë e rishikuar më tej, KSC-BC-2020/F00045/A03, 4 nëntor 2020, publike.

⁴ Po aty., paragrafët 32, 59-93, 97-134, 173.

⁵ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafi 5.

⁶ Po aty., paragrafi 6.

⁷ Po aty., paragrafi 16.

⁸ Po aty., paragrafët 18-20.

⁹ Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, neni 21(4)(c).

materialit, Mbrojtja nuk do të jetë në gjendje që të japë një vlerësim të njëmendtë lidhur me kohën që do t'i duhet për të përmbyllur hetimet e saj. Më tej, është e paqartë se në çfarë shkalle do t'i pengojë hetimet situata e tanishme me pandeminë e koronavirusit. Ka gjasa që kufizimet e tanishme botërore për udhëtimet, orët e mbylljes brenda në shtëpi dhe masat e tjera të ngjashme, do të vonojnë në mënyrë të ndjeshme hetimet.

III. PROBLEMET E NXJERRJES SË MATERIALIT

8. Mbrojtja vëren se, në këtë fazë, pyetjet në shtojcën e urdhrit për caktimin e datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për parashtrime, i janë drejtuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar¹⁰. Mbrojtja me gjasë do të ketë edhe parashtrime të tjera për të bërë lidhur me nxjerrjen e materialeve pasi të ketë nisur procesi.
9. Lidhur me rregullën 102(1)(a), Mbrojtja merr shënim parashtrimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar se në këtë rast kërkohet respektimi i “afatit ligjor të plotë” dhe se Zyra e Prokurorit të Specializuar momentalisht nuk parashikon që do të mund të nxjerrë ndonjë material përpara këtij afati¹¹. Mbrojtja është e mendimit se nxjerrja graduale e materialeve duhet të nisë sa më parë që të jetë e mundshme. Praktikisht, ka gjasa që të jetë më e lehtë të menaxhohet një nxjerrje graduale se sa të merret i gjithë materiali njëherësh. Më tej, rregulla 102(1)(a) përcakton se nxjerrja e materialeve mbështetëse të Aktakuzës duhet

¹⁰ Urdhër i caktimit të datës për mbajtjen e konferencës mbi ecurinë e çështjes dhe për paraqitjen e parashtrimeve, KSC-BC-2020-06/F00074, 11 nëntor 2020, publik.

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafi 7.

bërë “sa më shpejt që të jetë e mundshme”. Prokuroria tashmë ka pasur një kohë të konsiderueshme për tu përgatitur për nxjerrjen e materialeve, duke pasur parasysh që Aktakuza e rishikuar u paraqit për konfirmim më 24 korrik 2020¹². Rrjedhimisht, Mbrojtja është e mendimit se nxjerrja e materialeve duhet të fillojë sa më shpejt që të jetë e mundshme dhe do të ishte e dobishme sikur kjo të fillonte me dhënien e materialeve të paredaktuara.

10. Për sa i takon procedurës për nxjerrjen e materialeve, Mbrojtja ka marrë në shqyrtim propozimin e bërë nga ZPS-ja¹³. Mbrojtja pajtohet që të përdoret tabela e detajuar e propozuar për nxjerrjen e materialeve. Mbrojtja është e vetëdijshme që diskutimet ndërmjet ekipeve të Prokurorisë dhe Mbrojtjes janë në vijim e sipër dhe Mbrojtja do të vijojë të marrë pjesë në këto diskutime. Megjithatë, Mbrojtja nuk pajtohet me ZPS-në që tabela e detajuar për nxjerrjen e materialeve duhet të jepet vetëm pas paraqitjes së dosjeve të procedurës paraprake. Rregulla 109(c) vendos detyrimin mbi palët që të kategorizojnë materialin në përputhje me akuzat e Aktakuzës gjatë zhvillimit të procedurës së nxjerrjes së materialeve. Qëllimi i kësaj rregulle është që të ndihmojë Gjykatën dhe palën marrëse në përpunimin efikas të materialit të vënë në dispozicion. Propozimi i Zyrës së Prokurorit të Specializuar për të vonuar procesin e kategorizimit deri pas paraqitjes së dosjeve të procedurës paraprake është në mospërputhje me tekstin dhe qëllimin e kësaj rregulle. Duke pasur parasysh vëllimin e materialit që ka të ngjarë të bëhet i njohur në këtë çështje gjyqësore, është veçanërisht e rëndësishme që palët të marrin tabela të detajuara të nxjerrjes së materialeve me secilën paketë të materialeve të nxjerra si një mjet udhëzues për të ndihmuar palët gjatë fazës përgatitore. Mbrojtja

¹² Version i redaktuar publik i versionit të korrigjuar të fletarrestimit për Jakup Krasniqin, KSC-BC-2020-06/F00027, 26 tetor 2020, faqja 1.

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, paragrafi 23.

gjithashtu nuk pranon që “analiza që kërkohet për të krijuar tabelën” mund të nxirret vetëm nga paraqitja e dosjeve të procedurës paraprake¹⁴. ZPS-ja duhet realisht të kuptojë tashmë rëndësinë e dokumenteve mbi të cilat bazohet dhe të jetë në gjendje t’i kategorizojë ato në mënyrën e duhur. Për këtë arsye, ndërsa një tabelë përmbledhëse duhet patjetër të përgatitet në kohën e paraqitjes së dosjeve të procedurës paraprake dhe të jetë e bazuar në analizën e bërë brenda paraqitjes së dosjeve të procedurës paraprake, Mbrojtja është e mendimit se një tabelë e përshtatshme duhet të paraqitet me secilën paketë të nxjerrjes së materialeve.

11. Mbrojtja nuk pajtohet me pohimin se ZPS-së nuk duhet t’i kërkohet që të nxjerrë materiale potencialisht shfajësuese nga burime të hapura¹⁵. Formulimi i rregullës 103 është i qartë: Zyra e Prokurorit të Specializuar “i vë menjëherë në dispozicion Mbrojtjes *çdo* informacion” (shkronjat e pjerrëta janë shtuar) që mund të jetë shfajësues. Fraza “çdo informacion” përfshin qartë materialet nga burime të hapura. Rregulla është formuluar në mënyrë të përgjithshme në mënyrë që të sigurojë respektimin e të drejtave të Mbrojtjes. Për ZPS-në nuk duhet të jetë e domosdoshme që të bëjë një vlerësim nëse materiali shfajësues mund të sigurohet me zellin e duhur (që është në vetvete një çështje që mund të shkaktojë debate të tjera ligjore); Rregullorja thjesht kërkon nxjerrjen e menjëhershme të *të gjithë* materialit shfajësues

¹⁴Parashtrimet e ZPS-së, paragrafi 23.

¹⁵*Contra* Parashtrimet e ZPS-së, paragrafi 18.

IV. SISTEMI I REDAKTIMIT

12. Ndërsa Mbrojtja është e vetëdijshme që disa informacione mund të duhet të redaktohen në një numër të kufizuar rrethanash të përcaktuara qartë, shqetësimi i Mbrojtjes është se përdorimi i shumë redaktimeve rrezikon ta bëjë të padobishme nxjerrjen e materialeve, duke i mohuar Mbrojtjes mundësitë e duhura për tu përgatitur për çështjen gjyqësore. Nxjerrja e materialeve me redaktime të shumta do t'i pamundësonte Mbrojtjes që të përgatitej për gjykimin në mënyrë efektive, do të kufizonte aftësinë e Mbrojtjes për paraqitjen e mocioneve të fazës së procedurës paraprake dhe do të pakësonte aftësinë e Mbrojtjes për të bërë njoftimin paraprak për ndonjë mbrojtje afirmuese.

13. Duke pasur parasysh këta faktorë, Mbrojtja nuk e kundërshton miratimin e aspekteve të sistemit të redaktimeve që janë përdorur në çështjen gjyqësore¹⁶ *Mustafa*, që në vetvete nënvizon faktin se redaktimi i informacionit është më shumë një përjashtim sesa normë dhe se çdo redaktim duhet të jetë rreptësisht i domosdoshëm për një nga arsyet e përcaktuara¹⁷. Megjithatë, Mbrojtja është e mendimit se duhet të ketë një miratim paraprak gjyqësor të çdo redaktimi¹⁸. Nevoja për miratim gjyqësor është rrjedhojë e natyrshme e parimit se redaktimet kryhen në raste të jashtëzakonshme dhe duhet të jenë rreptësisht të domosdoshme. Mbrojtja propozon që procedura e parashikuar në çështjen gjyqësore *Mustafa* lidhur me 'redaktimet jostandarde' duhet të zbatohet për të gjitha redaktimet.¹⁹ Mbrojtja rezervon të drejtën për të kundërshtuar redaktime të veçanta apo për t'i kërkuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të

¹⁶ Vendim kornizë mbi nxjerrjen e materialeve, KSC-BC-2020-05/F00034, paragrafët 73-89.

¹⁷ Po aty., paragrafi 73.

¹⁸ Kundërshtim ndaj vendimit kornizë mbi nxjerrjen e materialeve, KSC-BC-2020-05/F00034, paragrafi 78

¹⁹ Vendim kornizë mbi nxjerrjen e materialeve, KSC-BC-2020-05/F00034, paragrafi 79.

shqyrtojë sistemin e redaktimeve, nëse do të bëhet e qartë se janë duke u bërë redaktime të tepruara.

/nëshkrim/

Venkatesvari Alagenda

E martë, 17 nëntor 2020

Në Kuala Lumpur, Malajzi.